

MUHARREM DEZHGIU

**“VATRA” PËR ÇËSHJTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE
NË VITET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE***

Veprimtaria e Federatës Panshqiptare “Vatra” gjatë një shekulli pati si bosht të saj themelor çështjen kombëtare shqiptare, duke i kushtuar asaj një mbështetje të fuqishme në arenën ndërkombëtare.

Krijimi i shtetit shqiptar pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen kombëtare shqiptare. Shtetit shqiptar iu desh të kalonte në shumë sfida të tjera, për të marrë përmbajtjen e një shteti kombëtar. Duke mos e patur këtë tipar shteti shqiptar u ndesh me pengesa të brendshme e të jashtme, të cilat rrezikuan dhe vunë në dilemë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Në të gjitha këto sfida, Federata Panshqiptare “Vatra” u bë mbrojtëse e flaktë e çështjes shqiptare, si një zëdhënëse e fuqishme e opinionit të shqiptarëve të diasporës.

Kumtesa synon të parashtrojë qëndrimin e shqiptarëve të Amerikës, nëpërmjet “Vatrës” ndaj pushtimit të huaj të Shqipërisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur çështja kombëtare shqiptare ndodhej përpara një rreziku qartësisht të dukshëm.

Diaspora shqiptare në Amerikë, para Luftës së Dytë Botërore, në përbërjen e vet, kishte intelektualë të njohur, të cilët e njihnin historinë e Shqipërisë, që në themelet e shtetit të pavarur. Ata njihnin në vijimësi peripecitë dhe pengesat, në të cilat kishte kaluar çështja shqiptare deri në pushtimin e fundit italian. Për rrjedhojë, ata kishin shprehur pikëpamjet e tyre për këtë problem, madje, në mënyrë të organizuar, nëpërmjet “Vatrës”.

Veprimtaria e tyre, e zhvilluar larg ambicieve dhe interesave të ngushta të ditës prodhonte gjykime dhe mendime më të besueshme, më objektive dhe më bindëse. Ndaj dhe mendimi i tyre ishte më racional, për t’u marrë në konsideratë në orientimin e zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare.

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore, me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Federatës Panshqiptare “Vatra”, organizuar nga Instituti i Historisë, pranë QSA, Tiranë, më 28 prill 2012.

Veprimtaria e “Vatrës”, e zhvilluar në një nga vendet demokratike perëndimore, me një hapësirë më të gjerë lirie në fushën diplomatike për çështjen shqiptare, e bënte më objektiv ndikimin e saj në Shqipëri. Që në fillim të agresionit italian, “Vatra” me veprimtarët e saj demaskoi propagandën e shfrenuar dhe bajate të fashizmit italian, lidhur me qëllimet e pushtimit të Shqipërisë. Në faqet e shtypit të “Vatrës” në Amerikë, thuhej qartë se, pushtuesit nuk i kërkonin kufijtë e Shqipërisë deri në Janinë, Selanik, Manastir e Shkup, se këto vende janë shqiptare dhe duhet t’i ktheheshin Shqipërisë, por ato kanë ndërmend t’i grabitin për vete, sikundër grabitën Shqipërinë e lirë¹.

Megjithatë, sipas analizës që i bënin situatës në Shqipëri, vatanet ishin realistë, duke bërë të ditur se, “Shqiptarët, edhe pse nuk e duan fashizmin, s’kanë fuqi të kundërshtojnë Italinë”. Nga ana tjetër, veprimtarët e “Vatrës” dënonin dhe kritikonin atë takëm shqiptarësh, që i quanin “shpirtkalbur”, të cilët shiteshin për para, për t’i bërë varrin Shqipërisë. Nën ndikimin e këtyre “shpirtkalburve” populli shtërngohej të vishte këmbësorë e zezë të fashizmit dhe të thërriste “rroftë” për këtë ose për atë “eksponent fashist”². Për shqiptarët e Amerikës, slogan i fashist, sipas të cilit, “Shqiptarët duhet të luftojnë për madhimin e vendit të tyre”, ishte një mashtrim i komandës italiane. Ky slogan kishte për qëllim motivimin e shqiptarëve për t’i çuar në vijën e parë të frontit të luftës e të vriteshin për interesat e Italisë.

Shqiptarët e “Vatrës” e bënë të qartë dallimin midis administratës fashiste, të vendosur në Shqipëri dhe popullit shqiptar. “Bota e di fort bukur, - shprehej “Dielli”, - se sot s’ka Shqipëri as qeveri shqiptare, por ajo është një koloni e vogël e Italisë. Për rrjedhojë, për të gjitha sulmet që ndërmori Italia ndaj fqinjëve të Shqipërisë, s’kishte faj as Shqipëria e as populli i saj”³. Një qëndrim i tillë realist, do të shërbente si strumbullar i argumentit për të hedhur poshtë pretendimet greke ndaj Shqipërisë, duke e akuzuar atë si shkaktare e agresionit italian kundër Greqisë.

Diplomacia dhe politika e demokracive të mëdha evropiane shpalosi një qëndrim të dyshimtë dhe të çuditshëm për pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë në periudhën fillestare të pushtimit të saj. Në

¹ “Italianët tallen me popullin shqiptar”, *Dielli*, organ i Federatës Panshqiptare “Vatra” (më tej: *Dielli*), Boston Mass., 1 korrik 1940.

² *Po aty*. Në *Dielli* përmenden emrat e këtyre eksponenteve të fashizmit, Tefik Mborja dhe Ettore Mutti.

³ “S’ka faj Shqipëria, as populli i saj”, *po aty*, f. 2.

mënyrë të veçantë një qëndrim i tillë vihej re në politikën dhe diplomacinë britanike. “Qeveria britanike, jo vetëm që bëri sytë e verbër ndaj dhunimit flagrant të ligjit ndërkombëtar, por ajo gjithashtu u përpoq të zvogëlonte asgjësimin e pavarësisë së saj, në sytë e komunitetit britanik dhe atij ndërkombëtar”⁴.

Ndërsa qeveria e SHBA, nëpërmjet deklaratës së Sekretarit të Shtetit, Cordell Hull, të bërë më 5 prill 1939, e konsideroi pushtimin e Shqipërisë nga Italia “një akt i dhunshëm dhe përdorim force, që kërcënonte paqen e botës”⁵.

Veprimtarët e “Vatrës” kërkonin që të bëhej presion ndaj qeverisë britanike dhe amerikane për të mbështetur, pa mëdyshje, rimëkëmbjen e pavarësisë dhe ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Në vitet 1941 dhe sidomos gjatë vitit 1942, në adresë të qeverisë britanike, u dërguan një sërë letrash, telegramesh e memorandumesh nga figura e personalitete të njohura, ku kërkohej respektimi i parimeve të Kartës së Atlantikut.

Shqiptarët e Amerikës dhe “Vatra” konsideronin detyrë të dorës së parë, përkrahjen dhe mbështetjen e përpjekjeve për formimin dhe njohjen ndërkombëtare të një qeverie shqiptare në mërgim. Aso kohe, ky organizëm, konsiderohej një faktor themelor juridik e politik për ruajtjen e statusit juridiko-territorial të shtetit shqiptar.

Nga ana tjetër, njohja e një qeverie të tillë, do të ishte faktor mobilizimi dhe organizimi i shqiptarëve në luftën e përbashkët çlirimtare, si dhe, një mbrojtëse e interesave shqiptare në arenën ndërkombëtare. Kjo gjë, ishte e domosdoshme edhe për faktin se, vendet fqinje të Shqipërisë kishin ruajtur qeveritë e tyre në mërgim pas pushtimit. Si të tilla, jo vetëm që mbronin me efikasitet interesat e tyre kombëtare, por po kryenin edhe veprimtari të ethshme politike e diplomatike për realizimin e synimeve aneksioniste të tyre ndaj Shqipërisë.

⁴ *Foreign Relations of United States (FRUS)*, Diplomatic Papers, 1939, volume II, General The British Commonwealth and Europe, Washington: 1956, p. 378, sipas Hamit Kaba në: *Studime historike*, nr. 3-4, 2009, f. 67.

⁵ *Peace and War: United States Foreign Policy 1931-1941*, US: Department of State Publication, 1983, f. 454, sipas H. Kaba në: *Studime historike*, nr. 3-4, 2009, f. 68.

E para tentativë për formimin e qeverisë në mërgim u bë vetëm pak ditë pas sulmit italian kundër Greqisë, duke theksuar se, kjo ngjarje “e kishte shtuar urgjencën e çështjes”⁶.

Korente të ndryshme të emigracionit shqiptar, të mbështetura në motive, sa kombëtare aq edhe juridike, e vlerësuan Zogun si figurë qendrore për krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim. Ai shihej si “përfaqësues legjitim i shtetit shqiptar dhe bartësi i vetëm i vazhdimësisë së tij konstitucionale”⁷.

Një qeveri, me A.Zogun në krye shihej si garanci jo vetëm për rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe për paprekshmërinë e kufijve. Në lëvizjen për krijimin dhe pranimin e një qeverie të tillë, u përfshinë përveç “Vatrës”, me përfaqësues F. Nolin, F.Konicën, K.Çekrezin, T.Zavalanin, edhe organizata të tjera, si Komiteti “Shqipëria e Lirë”, në përbërje të të cilave bënë pjesë Noli, Konica, Çekrezi, Zavalani etj. Në këtë lëvizje u përfshinë dhe shqiptarët që punonin në industrinë e luftës, në SHBA, të cilët me anë të një memorandumi, i kërkonin sekretarit të shtetit C.Hull të pranonte një qeveri shqiptare në mërgim, nën kryesinë e mbretit A.Zogu⁸.

Kërkesa e A.Zogut ndaj diplomacisë britanike, për t’u njohur si kryetar shteti në mërgim, sikurse ishin njohur homologët e tij të Greqisë e të Jugosllavisë, nuk u muar në konsideratë nga Forin Offisi⁹. Me sa dukej, në atë kohë, qeveria britanike nuk e kishte përcaktuar qartë qëndrimin që do të mbante kundrejt çështjes shqiptare¹⁰. Për Britaninë e Madhe pavarësia e Shqipërisë ishte vënë në dilemë.

Noli dhe Konica, me ndikim të fuqishëm në veprimtarinë dhe qëndrimet e “Vatrës”, i mbështetën pa rezerva përpjekjet e Zogut. Ata i

⁶ *British National Archives, London*, Foreign Office (më tej: FO) 371/24866, Kopje e letrës së Dervish Dumës dërguar Nolit dhe Nelo Dizdarit, kapur nga censura britanike, 6 nëntor 1940 (Cituar sipas B.Metës në: *Tensiononi greko-shqiptar, 1939-1949*, Tiranë: “Geer”, 2002).

⁷ *Po aty*, 371/33109, Relacion i P.Dixon-it mbi bisedën me Tajar Zavalanin, 3 korrik 1942.

⁸ *United States National Archives (USNA) DS. 87501/564, 1/2*, Memorandumi i shqiptarëve që punonin në industrinë e luftës, dërguar C.Hull-it (pa datë).

⁹ FO 371/33110, Raporte të Rajanit mbi bisedat me Zogun, 24 qershor dhe 3 korrik 1942.

¹⁰ FO 371/33109, Shënime të Dixon-it pas bisedës me T. Zavalanin, 3 korrik 1942.

argumentuan Departamentit të Shtetit Amerikan domosdoshmërinë e krijimit të qeverisë me Zogun në krye, duke e vlerësuar si “personaliteti më i shquar shqiptar”¹¹.

Noli i shprehte C.Hullit shqetësimin se, edhe pse deklarata amerikane ishte e shkëlqyer nga pikëpamja parimore, ishte e dënuar të mbetej në letër në qoftë se ajo (deklarata – M.D.) nuk do të përforcohej me garantimin e integritetit tokësor të Shqipërisë dhe me njohjen zyrtare të Mbretit Zog si kryetar legjitim dhe logjik i qeverisë shqiptare në mërgim, së cilës t’i garantohej edhe një vend në Konferencën e Paqes¹².

Mbështetja e fuqishme që i dha “Vatra” njohjes së një qeverie shqiptare, me Ahmet Zogun në krye, ishte një tregues i qëndrimit të vendosur ndaj çështjes kombëtare shqiptare në rrethanat e kohës. Noli dhe vatanët, edhe pas humbjes së Konicës në dhjetor 1942, mbajtën një qëndrim konstant, në mbështetje të çështjes shqiptare.

Diaspora shqiptare e Amerikës, nën drejtimin e “Vatrës” i shprehu bindjen e saj Departamentit të Shtetit Amerikan se “vetëm Fronti i Bashkuar Shqiptar nën udhëheqjen e mbretit Zog, ishte mënyra më efektive për të ndihmuar Shqipërinë dhe Kombet e Bashkuara”¹³.

Noli, i shqetësuar për pozitën e Shqipërisë, në raport me fqinjët, të cilët kishin në Londër dhe Washington ambasadorë dhe qeveri në mërgim, kishte arsyetuar: “Zogu mund të konsiderohej si një nga autoritetet që paraqiste një shpresë se mund të pranohej nga Aleatët si përfaqësues i vazhdimin të shtetit të pavarur shqiptar. Rrjedhimisht, rreth tij mund të krijohesh një qeveri shqiptare në mërgim e cila mund të pranohej nga qeveritë amerikane dhe britanike, gjë që do të siguronte njohjen e Shqipërisë si komb i bashkuar dhe njohjen e pavarësisë dhe tërësisë tokësore pas luftës. Kjo, - vazhdonte Noli në arsyetimin e tij, - do të pengonte e do të thyente intrigat e pretendimet tokësore të qeverive shoviniste greke e jugosllave në Londër”¹⁴.

Kundërshtarët e Monarkisë, me në krye Zogun, bënë përçapje të krijonin një komitet kombëtar shqiptar në vend të një qeverie, por, duke

¹¹ USNA. DS.FW.875.01/427, Promemorie e Nolit dhe e Konicës pas vizitës në Departamentin e Shtetit, 19 nëntor 1942.

¹² Po aty.

¹³ Po aty, 875.01/474, Telegram i Shaqir Buços, Asat Hasanit, Mehmet Kinakolicit, Hysen Panaritit etj., dërguar C.Hull-it, 28 dhjetor 1942.

¹⁴ Behar Shtylla, *Fan Noli siç e kam njohur. Kujtime*, Tiranë: “Dituria”, 1997, f. 112.

pranuar që ky komitet të kishte në krye Zogun. Një organizëm i tillë pa prerogativat e qeverisë, linte të hapur çështjen e përcaktimit të formës së regjimit të pasluftës. Për Zogun, pranimi i Komitetit, në vend të qeverisë, do t'u mohonte shqiptarëve të drejtat e fituara gjatë 20 vjetëve të shtetësisë së pavarur. Kjo rrezikonte që çështja shqiptare të shqyrtohej edhe njëherë nga fillimi, pa patur asnjë siguri, nëse rezultati do të ishte në interes të Shqipërisë. Ndaj, mbështetësit e Zogut, këmbëngulnin në krijimin e qeverisë legale, duke e konsideruar si garanci për mbrojtjen e pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë¹⁵.

Në rrethanat e përçarjes së emigracionit politik shqiptar, lidhur me krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim, diaspora shqiptare e Amerikës, e organizuar nga "Vatra", qëndroi në bindjen e saj për pranimin pa kushte të mbretit Zog si figurë qendrore politike rreth së cilës duheshin bashkuar shqiptarët.¹⁶

Duke i bërë një analizë çështjes së krijimit të qeverisë shqiptare në mërgim, "Vatra" do të hetonte dhe shkaqet e dështimit të përpjekjeve për krijimin e Frontit të Përbashkët. Ideja e krijimit të qeverisë në mërgim dështoi, së pari, se nuk gjeti përkrahje nga Aleatët, nga apatia e tyre kundrejt Shqipërisë dhe, së dyti, nuk deshën grupet shqiptare të Londrës (që bënë pjesë në Komitetin "Shqipëria e Lirë", që të vijnë në marrëveshje¹⁷. Harxhimi i energjive në këto përpjekje, në mënyrë të natyrshme, zbehu dhe zvarriti përpjekjet e shqiptarëve në emigracion për ta kundërshtuar propagandën dhe ofensivën diplomatike të qeverisë greke në Britaninë e Madhe dhe në Amerikë, me synime të qarta aneksioniste ndaj Shqipërisë.

Në verë të vitit 1944, situata ndërkombëtare dhe ajo në Shqipëri ndryshoi në mënyrë të vullshme. Goditja vendimtare që po merrte fashizmi në shkallë botërore, ndodhi në të njëjtën kohë me rritjen e ndikimit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Shqipëri, nën drejtimin e PKSH. Ndërkohë, për Shqipërinë rritej rreziku i copëtimit nga ofensiva politike e diplomatike e qeverisë greke. Në këto rrethana, shqiptarët e

¹⁵ FO 371/37137, Kopje e letrës së Sotir Martinit drejtuar T.Zavalanit, 11 maj 1943.

¹⁶ Po aty, Letër e T.Zavalanit dërguar Mis Barkerit, 24 tetor 1943.

¹⁷ "Shqipëria e Enver Hoxhës", *Dielli*, 16 dhjetor 1944.

Amerikës, të mbledhur në një meeting, miratuan një rezolutë për Fuqitë e Mëdha dhe Kombet e Bashkuara¹⁸.

Rezoluta kërkonte njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare në ekzil, ashtu siç kishte ekzistuar para 7 prillit 1939, si dhe pranimin e Shqipërisë me të drejta të plota në Kombet e Bashkuara. “Vatra” i bënte të ndërgjegjshëm bashkatdhetarët e vet për rrezikun që i vinte Shqipërisë. Ajo u kujtonte atyre qëndrimin kritik që kishte mbajtur ndaj politikës britanike që në vitin 1942, pas deklaratës së A.Edenit, në dhjetor të atij viti. Ajo vinte në dukje se deklarata britanike u përhap si sëmundje ngjitëse në të gjitha anët dhe nuk la asnjë grek pa zënë. Në Amerikë grekomanët “epirotë” hapën kuletat dhe nisën përsëri nga avazi i vjetër, me shpresë që t’i mbushnin kokën popullit amerikan, se shqiptarët janë grekë¹⁹.

Epërsia e forcave që drejtoheshin nga komunistët, në ngjarjet politike e ushtarake të Shqipërisë në fund të verës 1944 si dhe rritja e presionit dhe rrezikut grek në Shqipërinë e Jugut që kishte të bënte drejtpërdrejtë me interesat kombëtare, ndikuan dhe në qëndrimet e “Vatrës”. Ishin këto rrethana, që përmendëm, të cilat e bënë “Vatrën” të mbështeste qeverinë provizore komuniste, që u formua në Shqipëri, duke menduar se ajo do të mbronte interesat e Shqipërisë, kundër copëtimit të saj. “Fakti është që, sot për sot, kjo është qeveria që ka populli shqiptar, këtë qeveri duhet të përkrahim edhe ne”²⁰. Madje, “Vatra” shtroi detyrën që, Komuniteti Amerikano-Shqiptar duhet të kërkojë sa më shpejt nga Guverna Amerikane njohjen e kësaj qeverie për prurjen e misionit nga Shqipëria. Duke iu përmbajtur këtij qëndrimi, “Vatra” theksonte se, “Gjersa të kapëxhejmë rrezikun e copëtimit të Shqipërisë, detyrë e çdo shqiptari është të përkrahë me gjithë shpirt guvernën provizore të E.Hoxhës”²¹.

Në rrethanat e ndërlikuara dhe komplekse të Luftës së dytë Botërore, ku ndërthureshin faktorë të brendshëm e të jashtëm, që rrezikonin çështjen kombëtare shqiptare, “Vatra” mbajti një qëndrim konsekuent në shërbim të mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit tokësor të Shqipërisë, duke mbështetur atë forcë qeverisëse në Shqipëri që mendohej se i shërbente interesave të larta kombëtare. Për vatrën ishte e rëndësishme

¹⁸ FO 371/43555, R179/71/90, Telegram dërguar A. Edenit nga kryesia e Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë (Christ Lepon, P. Danushi, Christ Skurte, Ismail Emini, etj.) 9 qershor 1944.

¹⁹ “Toskëria sot”, *Dielli*, 18 nëntor 1944.

²⁰ *Po aty*, 28 tetor 1944.

²¹ “Shqipëria e E.Hoxhës”, *po aty*, 16 dhjetor 1944.

që vendi të kishte një qeverisje që t'i delte në mbrojtje pavarësisë dhe tërësisë tokësore të Shqipërisë. “Vatra” e linte të hapur çështjen e qëndrimit ndaj kësaj qeverie, me shpresën se, “Nesër, po të jetë se bëhet një qeveri tjetër, e cila të përmbledhë të gjitha partitë edhe të pëlqehet e të njihet prej Aleatëve, edhe ne, duhet ta ndihmojmë me çfarë të mundim”²².

Qëndrimi i “Vatrës” do të ndryshonte më vonë, kur në Shqipëri, nuk u lejuan parti të tjera në qeverisjen e vendit, por po vendosej diktatura komuniste. “Vatra” nuk e mbështeti qeverinë komuniste të Shqipërisë për qëndrimet dhe veprimet antidemokratike të saj, ndaj shqiptarëve. Në këto rrethana, veprimtarët e saj u dalluan dhe për dimensionin antikomunist të tyre, i cili u shërbente përpjekjeve për çështjen kombëtare shqiptare dhe për vendosjen e demokracisë në Shqipëri, sipas modelit amerikan.

²² *Po aty*, 28 tetor 1944.